



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 83, Datë 30.03.2021

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “REI - ENERJJI” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA HEC “LINGJACA 1” ME
KAPACITET TE INSTALUAR 1897 KW, HEC “LINGJACA 2” ME KAPACITET TË
INSTALUAR 300 KW, ME KAPACITET TOTAL TE INSTALUAR 2197 KW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a”, nenit 13, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 30.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 39/2 prot, datë 24.03.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi licencimin e shoqërisë “REI – ENERJJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lingjanca 1” me kapacitet të instaluar 1897 kW dhe “Lingjanca 2” me kapacitet të instaluar 300 kW, me kapacitet total të instaluar 2197 kW.,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 56, datë 22.02.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “REI – ENERJJI” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lingjanca 1” me kapacitet te instaluar 1897 kW, HEC “Lingjanca 2” me kapacitet të instaluar 300 kW, me kapacitet total të instaluar 2197 kW, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit të Lingjances, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan, për një afat 25 vjet e 10 muaj.
- Në vijim të vendimmarrjes së ERE-s, me shkresën nr. 6/8 prot., datë 22.02.2021, është bërë publikimi në median e shkruar në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për HEC-et: “Lingjanca 1” dhe HEC “Lingjanca 2” dhe në përfundim të afatit të njoftimit, nuk rezulton të ketë patur vërejtje apo ankesa nga palë të interesuara.

- ERE, me shkresën nr. 424 prot., datë 05.03.2021, ka njoftuar shoqërinë “REI – ENERGGJI” sh.p.k, lidhur me vendimmarrjen e bordit, për fillimin e procedurave për licencimin e saj në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duke i bërë me dije nevojën për të depozituar dokumentacionin e konstatuar si të munguar apo plotësuar pjesërisht sipas vendimit nr. 56/2021.
- Shoqëria “REI - ENERGGJI” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 424/1 prot., datë 16.03.2021, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.
- Nga analiza e dokumentacionit në fazën përfundimtare të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “REI - ENERGGJI” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”, **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”. **Plotësuar;**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal., Neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar;**
 - Dokumentacioni teknik për HEC, Neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat “a”, “b”, “c”, “d”, dhe pika 4.1.4, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”. **Plotësuar.**
 - Leje nga institucione të tjera, Neni 9, pika 4.1.5, germat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë prodhimi nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*.
- Shoqëria ka saktësuar edhe emërtesën e HEC-eve duke konfirmuar se emërtesa e saktë është: “Lingjanca 1 dhe Lingjanca 2” dhe përdorimi në disa nene të kontratave me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) si Lingjaca është gabim ortografik.
- Në përfundim të Afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë e Përrenjasit, (data e përfundimit: 13.05.2027) shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.
- Kontrata nr. 57 REP., nr. 16 KOL., datë 23.01.2012, “Kontratë e formës BOT ndërtim- operim-transferim, për ndërtimin e Hidrocentralit Lingjanca”; ka një afat 35-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE në zbatim të nenit 38, të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5, të *Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*, e ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

- Në rastin konkret konstatohet se kontrata e koncesionit sipërcituar është nënshkruar në datën 23.01.2012 (data efektive) dhe si e tillë shoqëria ka humbur 9 vite nga periudha e koncesionit. Në nenin 5, “Kohëzgjatja e Vlefshmërisë së Licencës”, pika 2, të Rregullores së licencimit përcaktohet se: Për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE me vonë se data efektive e kontratës/autorizimit, llogaritja e afatit të licencimit, bëhet për periudhën e mbetur. Ky rregull vlen edhe për rastet e modifikimit të licencave”. Sa më sipër, nisur nga llogaritja e afateve të humbura të koncesionit, kjo shoqëri duhet të licencohet për një periudhë 25 vjet e 10 muaj.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “REI – ENERGJI” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Lingjanca 1” me kapacitet të instaluar 1897 kW, HEC “Lingjanca 2” me kapacitet të instaluar 300 kW, me kapacitet total të instaluar 2197 kW, për një afat 25 vjet e 10 muaj.
2. Shoqëria “REI ENERGJI” sh.p.k., në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Përrenjas, (data e përfundimit 13.05.2027), duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI